

## **DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS NË 33 VITE PJESË E UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

**ALBA ÇOMO., ENDRI XHINA.**

Departamenti i Informatikës u krijua nga njerëz që kishin një vizion: ‘Si do të përshtatet Informatika në frymën unike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, një institucion i orientuar rreth edukimit universitar dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërinstiucional’. Katedra e Informatikës u krijua në vitin 1984 pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Krijimi i saj shënoi kurorëzimin e përpjekjeve disavjeçare për të përgatitur kuadro të mirëfillta informatike në vend. Plani mësimor i hartuar si dhe programi ishin të përafërt me planet dhe programet mësimore të disa universiteteve perëndimore. Fillimisht dega u hap me 15 studentë të cilët pothuajse të gjithë ishin nga më të mirët e vendit. Pas 33 vitesh, numri i studentëve të pranuar në vitin e parë ka arritur në kuotën 300 studentëve.

Departamenti i Informatikës ka patur kontributin e disa profesorëve të nderuar të cilët kanë ndihmuar në hedhjen e themeleve të degës së Informatikës si dhe kërkimit shkencor në këtë fushë, duke qënë promotor të zhvillimit të Informatikës në të gjithë vendin. Ndër të cilët do të përmendim profesorët që kanë drejtuar për disa vite katedrën/departamentin e Informatikës që nga themelimi i saj, si Prof. Dr. Kristjan Bukuroshi, Prof. Dr. Maks Raço, Prof. Dr. Eqerem Arkaxhiu dhe Prof. Dr. Ilia Ninka. Një numër i konsiderueshëm anëtarësh të departamentit kanë dhënë kontributin e tyre për aplikimin e Informatikës në vitet e para të përhapjes së saj në Shqipëri, duke rezultuar një pjesë prej tyre në themelimin e kompanive të para Informatike në vend, të cilat janë sot një ndër bizneset më të sukseshme në këtë fushë.

Një pjesë e të diplomuarve në degën e Informatikës që në fillimet e saj, kanë vijuar të kontribuojnë në fushën e Informatikës si në kërkimin shkencor duke u bërë pjesë e katedrave/departamentëve dhe grupeve kërkimore në Universitete me emër edhe jashtë vendit tonë, si për shembull në Gjermani, Amerikë, etj.

Që në fillimet e saj katedra e Informatikës ka patur kontakt dhe shkëmbime me institucione dhe koleg nga vende të tjera, duke rritur kështu dora-dorës infrastrukturën informatike me paisje dhe laboratore të avancuara për kohën. Gjatë periudhës së tranzicionit, pas viteve 90 kur ndodhi emigracioni masiv në vendin tonë, kjo ndikoi dhe në departamentin e Informatikës, ku shumë anëtarë të departamentit u larguan në vende të tjera më të zhvilluara. Në vitin 2001 departamenti i Informatikës kishte gjithsej 7 anëtarë, ku vetëm dy prej tyre ishin me titullin Profesor. Në vazhdimësi, departamenti është rritur në mënyrë graduale, ku aktualisht Departamenti i Informatikës përbëhet nga 27 punonjës të brendshëm, prej të cilëve 3 me titullin Profesor i Asociuar, 8 me gradën Doktor dhe 16 me gradën Master i Shkencave (të

gjithë në proces të përfundimit të studimeve në ciklin e tretë, doktoraturë). Punonjësit e jashtëm janë të shumtë.

Në kushtet e një departamenti me një moshë mesatare rreth të 30-ve dhe me një numër të konsiderueshëm doktorantësh, departamenti ka intensifikuar aktivitetin e tij shkencor duke rezultuar tashmë në një diversitet të strukturuar të interesave dhe kapaciteve shkencor. Fushat e kërkimit shkencor që realizohen pranë departamentit janë: Semantika Web, Sistemet GIS, Sistemet Inteligjente, Data mining, Sistemet e Qeverisjes dhe Organizatave, Sistemet e-health, Sistemet e-learning, Fusha e bashkëveprimit njëri kompjuter dhe studimi i ndërfaqeve natyrale për njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.

Në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm, sidomos gjatë dy dekadave të fundit të Informatikës dhe të natyrës aplikative të saj, anëtarët e departamentit kanë kontribuar në kuadër të aplikimit të interesave të tyre shkencore në një sërë projektesh aplikative në sektor të ndryshëm në vendin tonë. Anëtarët e departamentit kanë marrë pjesë duke ofruar ekspertizën e tyre në institucionet qeveritare, si ndërtimin e një:

- Data center të përqëndruar qeveritar sipas praktikave më të mira të zhvillimit në vend.
- Sistemi ERP në Ministrinë e Punëve të Brendshme, implementimi më i madh i këtij lloji në Shqipëri.
- Sistemeve publike administrative për shërbimet e pushtetit vendor.
- Sistemeve në shumë institucione të tjera qeveritare si DPPP, Ministria e Integrimit, Komiteti Zgjedhor, Policia e Shtetit Shqiptar, Bashkia e Tiranës, Gjykata e Lartë, etj.

Anëtarët e departamentit të Informatikës, kanë dhënë kontributin e tyre dhe në ndërtimin dhe zhvillimin e sistemeve të informatikës në Institucionet Financiare dhe të Sigurimeve, si Banka BKT, Union Bank, Alpha Bank, Raiffisen Bank, Tirana Bank, Sigal Uniqa Group, etj. Në fushën e Telekomunikacionit disa anëtarë të departamentit kanë qënë pjesëmarrës në projekte si ekspertë apo zhvillues në sistemet Pre-paid, Valued Added, Business Intelligence dhe Sistemet e Raportimit, etj. Këtu mund të përmendim instucione si Telekom, Albtelecom, Plus Communication, etj. Gjithashtu, kanë dhënë kontributin e tyre në ndërtimin e programeve aplikative me teknologji të ndryshme si ERP, CRM, etj.

Departamenti ka qënë aktiv si në aplikime dhe në pjesëmarrje në projekte të ndryshme ndër të cilat mund të përmendimin projektin ‘Unë-Mësoj (I-Learn)’. Qëllimi i këtij projekti ishte ndërtimi i një sistemi informacioni për mësimdhënien elektronike të gjuhës së shënjave, ku përfitues është komuniteti i personave që nuk dëgjojnë. Projekti është zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike dhe Institutin e Personave që nuk Dëgjojnë (ANAD).

Gjatë vitit 2017 departamenti ka aplikuar në 4 projekte për fonde europiane të kërkimit. Gjatë dy viteve të fundit, departamenti ka shfrytëzuar në mënyre

energjiike mundësitë e ofruara nga programet e mobilitetit duke rezultuar në 8 mobilitete me programin Erasmus +, në universitete jashtë vendit, në shtetet si Itali, Poloni, Hollandë, Angli, etj dhe një mobilitet në Amerikë me programin Fullbright.

Në lidhje me ndërkombëtarizimin, departamenti ka shprehur gadishmërinë për ofrimin e programeve të ciklit të dytë në gjuhën angleze dhe është në proces diskutimi për realizimin e një programi double-degree me një universitet të Bashkimit Europian. Në vijimësi të ndërkombëtarizimit një numër i konsiderueshëm i studentëve (rreth 50 studentë vetëm gjatë vitit 2017) kanë shfrytëzuar mobilitetet Erasmus për të zhvilluar një semester pranë universiteteve Europiane.

Sot departamenti i Informatikës, i shërben mbi 1500 studentevë në të dy ciklet, ku vetëm 1200 studentë shërbehen gjatë ciklit të parë. Departamenti ofron dy diploma në ciklin Bachelor, 2 diploma në ciklin Master Profesional dhe 3 diploma në ciklin Master Shkencor, përkatësisht:

- Bachelor në Informatikë dhe Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.
- Master Profesional në Informatikë Biznesi dhe Teknologji Informacioni
- Master Shkencor në Informatikë, Teknologji Informacioni dhe Informatikë me profil 'Mësues Informatike për arsimin e mesëm dhe të lartë

Në kushtet e zhvillimit të teknologjisë dhe të nevojës në rritje për informaticien të përgatitur në treg, mbetet ende një sfidë rritja e burimeve njërezore e departamentit, si edhe e infrastrukturës në përgjithësi dhe e laboratorëve në funksion të mësimin dhe kërkimit shkencor në vençanti.

Departamenti i Informatikës beson fuqimisht në dialogun midis studenteve, pedagogëve, stafit kërkimor, vizitorëve dhe kolegëve në departamente të tjera brenda fakultetit dhe jashtë tij. Departamenti beson se ky dialog duhet të fillojë më herët, që kur një student fillimisht humulton dimensionet emocionuese të kësaj fushe. Nxënësit janë të inkurajuar të punojnë apo të humulojnë departamentin. Në vitin 2016, disa pedagogë të departamentit implementuan platformën 'Këndi i Programuesve të vegjël' ('YPS - Young Programmer Space'). Platformë, e cila ofron shkrimin e programeve në gjuhë të ndryshme programimit përfshirë C, C++. Në Maj të këtij viti u realizua dhe një takim me nxënësit dhe mësuesit e gjimnazeve, pranë ambjenteve të departamentit duke zhvilluar dhe një orë të hapur diskutimesh rreth teknologjisë së informacionit, e cila është bërë pjesë e pandarë e jetës tonë. Në këtë projekt u realizua dhe një konkurs i studentëve në platformën 'YPS'. Një projekt i tillë u hap dyert shumë të rinjve për të qenë sa me të informuar dhe sa më afër asaj që departamenti jonë ofron.

Në funksion të marrjes së studentëve të mire në degën e informatikës, në vitin 2016 është hapur dhe programi Master Shkencor me profil 'Mësues

Informatike për arsimin e mesëm dhe të lartë', duke plotësuar një boshllëk me figura profesionale për formimin e informatikës që në shkollat e mesme.

Çdo dy vjet, Departamenti i Informatikës organizon një konferencë ndërkombëtare, Konferenca RTA-CSIT Recent Trends and Applications in Computer Science and Information Technology, e cila ka mbledhur rreth vetes aktorë të fushës akademike, të sektorit privat dhe atij qeveritar e ku trajtohen sfida, tendenca dhe zgjidhje në lidhje me aplikimet e teknologjive të informacionit dhe inovacionit. Kjo konferencë përveç se ka shërbyer si një platformë e nxitjes së debatit shkencor, krijimit dhe forcimit të lidhjeve me kërkues në rajon dhe më gjërë, ka qënë gjithashtu edhe një moment reflektimi i brendshëm mbi mënyrën sesi mund të përmisohemi më tej.

Takimet e kësaj natyre, siç është edhe kjo konferencë e organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në kuadrin e 60 Vjetorit të Universitetit të Tiranës, të shërbejnë për të celebruar arritjet, evidentuar mundësitë për përmirësim dhe në mënyrë të veçantë mundësitë për bashkëpunim dhe kërkim ndërdisiplinor shkencor. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përmbledh disa departamente që mbulojnë disa fusha të ndryshme të kërkimit shkencor, si Kimi, Biologji, Matematikë, Fizikë, Informatikë, etj., kjo fushë e gjërë e kërkimit shkencor pranë fakultetit tonë lehtëson dhe rrit ndjeshëm bashkëpunimin dhe kërkimin ndërdisiplinor shkencor ndërmjet departamentëve të ndryshëm. Nga kjo marrim, shkas për të falendruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me Dekan Spiro Drushkun për organizimin e kësaj konference.